



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 287/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osman i dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkizazi me ankesën e Lëvizja Vetëvendosje (LVV), paraqitur kundër Avdi Morina asambleist i subjektit politik Nisma për Kosovë, për shkak të kërcënimit të bëre gjatë ditës së zgjedhjeve ndaj anëtarit në KKZ-së në Malishevë Valon Hoti, , për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me dt. 12.06.2014, mori këtë:

## VENDIM

**Refuzohet si e pabazuar ankesa e Lëvizja Vetëvendosje (LVV)**

### Arsyetim

PZAP-i, më datë 09.06.2014 ka pranuar një ankesë nga LVV, me të cilën pretendohet se me datën 08.06.2014 rrëth orës 13:10 në në zyret e kuvendit të komunës së Malishevës ku ndodhen edhe zyret e KKZ-së, asamblisti nga Nisma Avdi Morina ka hyrë në këtë objekt dhe në hollin e këtij objekti ka kërcënuar anëtarin e KKZ-së nga LVV-ja Valon Hotin me fjalët kërcënuese “ruaju se ka me të kushtuar se ti po na vë pengesa në planet tonë”. I gjithë ky veprim sipas parashtreesit të ankesës ka ardhur përshkak që siç thuhet se anëtar i LVV-së në KKZ Valon Hoti ka arritur që përmes angazhimit profesional të parandalon shumë aktivitete e shkelje të jashtëligjshme të subjektit Nisma. Me këtë rast anëtar i LVV-së në KKZ ka arritur që ta fotografon asamblistin e dhe kandidatin Avdi Morina dhe se për rastin në fjalë ka lajmruar policinë dhe prokurorinë kompetente.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik Nisma për ankesën që është bëre ndaj saj dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës në fjalë deri më datë 11.06.2014 deri në ora 10:00

PZAP-i, pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik Nisma, në të cilën përgjigje theksohet se ankesa në fjalë është e pabazuar pasi që Avdi Morina nuk është deputet i Nismës pasi që ky subjekt nuk ka garuar në zgjedhjet lokale pasi që nuk ka qenë i themeluar në atë kohë, fotoja që shihet është foto në shkollën ku Avdi Morina punon

si profesor dhe se këtë foto ka mundur kushdo që ta marrë nga interneti dhe se gjatë ditës së zgjedhjeve nuk ka pasur ndonjë arsyqe te shkohet në KKZ dhe që të vihen pengesa, pasi që edhe nga deklarata e Valon Hotit shihet se nuk ka qenë prezent askush aty për çka e vënë në dyshim atë për çka thuhet.

PZAP-i lidhur me këtë e njoftoi Policinë e Kosovës dhe kërkoi që të ofroj informacionet e kërkuar për rastin në fjalë.

Në raportin e policisë të Kosovës theksohet se ankesa është pranuar nga prokurori i shtetit dhe lidhur me ankesën stacioni nuk është i njoftuar për masat e ndërmara nga prokurori.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

### **ankesa është e pabazuar**

PZAP-i gjeti se pretendimet e tilla ankimore nuk qëndrojnë pasi që as nga shkresat e lëndës dhe as nga raporti i policisë nuk ka prova dhe nuk është vërtetuar se anëtari i LVV-së në KKZ në Malishevë Valon Hoti ka qenë i kërcënuar nga Avdi Morina asambleist në Malishevë nga subjekti politik Nisma për Kosovë, prandaj ankesa e tillë në mungesë të provave përtu vërtetuar ajo për të cilën thuhet në ankesë është e pa bazuar dhe e pa argumentuar me ato për çfarë u tha në ankesë, andaj PZAP-i në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 287/2014 më datën 12.06.2014



#### ***Udhëzim Juridik:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkeshat përi-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5,000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.